



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA ND RYSHE**

*29 prill 2014, Prizren*

**KOMUNIKATË PËR MEDIA  
DUPH nuk lëshon leje por DSHP lejon vendosjen e lojërave**

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë muajve të kaluar ka adresuar përsëri çështjen e vendosjes së lojërave (Luna Parkut) në afërsi të Qendrës Sportive “Sezai Surroi” në Prizren, pas ankesave që ka pranuar nga banorët që jetojnë në lagjet përreth.

Qytetarët e këtyre lagjeve, pas paraqitjes verbale të ankesave, që ishin publikuar nga EC Ma Ndryshe ([http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_korrik\\_2.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_korrik_2.pdf)), me mbështetjen e marrë nga monitoruesit kanë iniciuar mbledhjen e nënshkrimeve me anë të cilit petition nga vendimmarrësit komunal kanë kërkuar ndalimin e vendosjes së lojërave në brendi dhe afërsi të Qendrës Sportive, pasi që pakënaqësia e tyre në këtë drejtim ishte anashkaluar për vite me radhë.

Banorët janë ankuar se vendosja e lojërave prish qetësinë, i privon ata nga përdorimi i hapësirës së gjelbër, shkakton kaos në komunikacion por edhe rrezikon sigurinë e tyre gjatë muajve të pranverës dhe verës.

Peticioni me 82 nënshkrime të banorëve, duke u bazuar në nenin 69 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale mbi “Të drejtën e petitionit” dhe nenet 95 dhe 96 të Statutit të Komunës së Prizrenit mbi “Petitionet” dhe nenin 6 të Rregullores për Transparencë të komunës së Prizrenit mbi “Petitionet” është dorëzuar për shqyrtim te organet komunale më 23 janar të këtij viti dhe si i tillë ende nuk është shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit.

Pas dorëzimit të petitionit, EC Ma Ndryshe më 28 janar ka pranuar një shkresë nga DKRS (Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport) ku thuhet se Menaxhmenti i Qendrës Sportive është rekomanduar nga komuna që vendosjen e lojërave ta lejoj vetëm pa muzikë dhe pa zhurmë. Ndërsa DUPH (Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor) më 29 janar ka bërë të ditur se si organ kompetent nuk ka pajisur asnjë kompani me leje për vendosjen e lojërave në këtë zonë.

Megjithatë lojërat në fillim të këtij muaji janë vendosur përsëri në parkingun përballë Qendrës Sportive, me leje të autoriteteve komunale. Pas insistimit të EC Ma Ndryshe për të marrë informata në lidhje me fatin e petitionit të dorëzuar, DSHP-ja (Drejtoria e Shërbimeve Publike) më 14 prill 2014 ka njoftuar se ky organ ka lëshuar leje për vendosjen e parkut të lojërave, duke u thirrur në praktikat që zbatohen në shumë qytete të rajonit dhe më gjerë në Evropë.

Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e lojërave është lëshuar prej 1 prillit deri më 31 maj 2014, me ç’rast operatori duhet të paguaj 793 euro për 100 m<sup>2</sup>. Në leje specifikohet se gjatë kohës së veprimit operatori nuk duhet të shkaktoj zhurmë bezdisëse, derisa duhet të ofroj siguri për stafin dhe klientët.

“Sa i përket reagimit të një grupi të qytetarëve, rreth vendosjes së lojërave në këtë lokacion organet komunale e kanë shqyrtuar, por duke pasur parasysh nevojën e të rinjve dhe fëmijëve për argëtim është vendosur që të lejohen, por me kriteret për mos bezdisje të qytetarëve”, thuhet në njoftimin e DSHP-së (Drejtorisë së Shërbimeve Publike).

Ndërkaq DUPH-ja (Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor) më 18 prill 2014 ka njoftuar se nuk ka lëshuar leje për vendosjen e këtyre lojërave dhe ka sqaruar se ato “janë pa leje”. Kjo drejtori ka theksuar se edhe nëse do të ketë kërkesa për pajisje me leje ato do të refuzohen.

EC Ma Ndryshe sikurse vitin e kaluar përsërit qëndrimin se nevojitet një nivel më i lartë i përgjegjësisë së organeve komunale për të trajtuar ankesat legjitime të qytetarëve në këtë pjesë të qytetit.

Në bazë të Nenit 96 të Statutit të Komunës, “Kryesuesi i Kuvendit, çdo petition të vlefshëm ia prezanton Kuvendit të Komunës në afat prej 45 ditësh nga dita që ai e pranon. Kuvendi i Komunës, petitionin dhe rekomandimet lidhur me të mund t’ia referojë për shqyrtim paraprak një komiteti të caktuar, ku parashtruesi i petitionit ka të drejtë të marrë pjesë në pajtim me rregullat e procedurës. Vendimin përfundimtar për çështjen e petitionit e merr Kuvendi i Komunës në afatin prej 45 ditësh nga dita e prezantimit të petitionit në Kuvend”.

Afati i parë kohor ka skaduar prej javësh. Kryesuesi i KK-së është zotuar se çështjen do ta paraqes në muajin maj në KPF dhe në KK. Ndërkohë ka disa ditë që ka skaduar edhe afati i dytë, mbi vendimin përfundimtar në lidhje me petitionin, ndërkohë që lojërat tashmë janë vendosur.

EC Ma Ndryshe gjithashtu konstaton se qëndrimet e organeve komunale nuk kanë konsistencë, ngase derisa DUPH-ja (Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor) thotë se do të refuzoj lëshimin e lejeve të kësaj natyre, DSHP-ja i pajis operatorët me leje, e qytetarët duhet të përballen sërish me problemin e njëjtë.

Bazuar mbi këto të gjetura EC Ma Ndryshe, rekomandon Komunën e Prizrenit që të:

- Dëgjoj me vëmendje shqetësimet e qytetarëve dhe të veproj urgjentisht me qëllim të krijimit të një ambienti më të mirë jetësor për ta, në secilin rast;
- Zbatoj dispozitat e LVL-së, Statutit të Komunës së Prizrenit dhe Rregullores për Transparencë mbi “Petitionet” dhe të respektoj të drejtën e qytetarëve për adresim të çështjeve me anë të petitionit;
- Koordinoj punët mes drejtorive gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje për shfrytëzimin e hapësirës publike;
- Inspektoj respektimin e kriterëve të përcaktuara në lejen e lëshuar nga DSHP-ja.

Po ashtu rekomandohet MAPL-ja që si mbikëqyrëse e pushtetit lokal të merr masa për respektimin e mekanizmit të petitionit nga Komuna e Prizrenit.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me

qeverinë lokale të Prizrenit, të Mamushës dhe të Prishtinës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V) - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*